



Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për :	Ragip Begaj, Kryetar i Komunës së Malishevës Aziz Thaçi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Malishevës	
Cc:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Ivan Todosijević, Ministër i MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Shkelqim Jakupi, U.D Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL	Datë: 02.06.2017
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së Vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës	Nr. 020-821
Lloji i aktit	Vendim	

I nderuar Kryetar,

I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr. 02/171 për miratimin e Planit të Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2017
I miratuar më datë: 25.05.2017
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 01.06.2017

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za:	Ragip Begaj, gradonačelnik opštine Mališevo Aziz Thaçi, predsedavajući Skupštine opštine Mališevo	
Kopija:	Jedinica za upravljanje dokumentima u MALS Jedinica za upravljanje dokumentima u opštini	
Preko:	Ivan Todosijević, ministar MALS-a, Rozafa Ukimeraj, generalni sekretar MALS-a	
Od:	Shkelqim Jakupi, v.d. rukovodioca pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MALS	Datum: 02.06.2017
Predmet:	Potvrda zakonitosti odluke Skupštine opštine Mališevo.	Br. 020-821
Vrsta akta:	Odluka	

Poštovani gradonačelnice,
Poštovani predsedavajući,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosova br.01/2016 za administrativno razmatranje opštinskih akata, i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva, određenim osnovnim zakonima i Vladinom Uredbom br.02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta premijera i ministarstva, odeljenju za pravna pitanja i monitorisanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave je dostavljen sledeći opštinski akt za obavezno razmatranje zakonitosti, onako kako se predviđa članom 81 Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi:

Odluka br. 02/171 za usvajanje plana rada opštinskog veća za bezbednost u zajednici za 2017
Usvojena dana: 25.05.2017. godine
Dostavljena MALS-u za razmatranje dana: 01.06.2017. godine

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog opštinskog akta, ceni da je opštinski akt u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvoditi pravni efekat. Ministarstvo administracije lokalne samouprave, ostaje na raspolaganju opštine za bilo kakvo dalje objašnjenje u vezi sa ovom procenom.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës

Nr. 02/

Datë: 30.05.2017

31-05-2017
2/171

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d, nenit 40 paragrafi 2 pika d, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 9 paragrafi 1 pika 7 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL, si dhe bazuar në nenin 19 të Statutit të Komunës së Malishevës Nr.01/871 datë:12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e I (parë) urgjente për vitin 2017 të mbajtur me datë: 25.05.2017 mori këtë:

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS TË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË
BASHKËSI PËR VITIN 2017

Neni 1

Miratohet, Plani i punës i Këshillit Komunal për siguri në Bashkësi në Komunën e Malishevës për vitin 2017.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani vjetor i punës për vitin 2017.

Neni 3

Për ekzekutimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës, përmes organëve Kompetente.

Neni 4

Ky vendim do të hyjë në fuqi nga dita e miratimit nga ana e kuvendit të Komunës së Malishevës, përkatësisht pas plotësimit të kriterëve ligjore të parapara me Ligjin për vetëqeverisjen lokale në Republikën e Kosovës.

Vendimi ju dërgohet;
Anëtarëve të KKSBB-së
Arkivit të Komunës
MAPL-së.

Kryesuesi i Kuvendit
Dr. Aziz Thaci

HYRËSE-ULAZNA-INCOMING			
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO			
BEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVO			
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal			
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije			
Ministry of Local Government Administration			
Data 01.06.2017			
Date			
Niveli organizativ	Sër i Lartës	Shtojca	Vlera
-V-	020-821		



Republika e Kosovës
KOMUNA E MALISHEVËS

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

Projekt Propozim i:

PLANIT TË PUNËS së KKSb-së, për vitin 2017

Malishevë: Dhjetor' 2016

Të nderuari!

Mbështetur në nenin 7 të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë, nenin 9, paragrafi 1, pika 7, të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB - 03/2012 MAPL, Koordinatorii KKSb-së, dhe modelit të udhëzuar nga MPB-DSP, në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës, Komandantin e Stacionit Policor në Malishevë dhe anëtarë të KKSb-së harton:

Planin e punës së KKSb-së për vitin 2017

Planin e punës së KKSb-së së komunës së Malishevës për vitin 2017, ka për qëllim që ti bashkërendoj dhe koordinoj aktivitetet e punës së Këshillit dhe të anëtarëve të KKSb-së, në mënyrë që të arrihen objektivat në ngritjen e sigurisë së përgjithshme publike të të gjitha komuniteteve, siq janë:

- rritja e vetëdijesimit të qytetarëve lidhur me natyrën e krimeve, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme në komunitetin lokal;
- identifikimi i brengave lidhur me sigurinë publike;
- rekomandimi i planeve të veprimit dhe adresimi i brengave të qytetarëve te autoritetet komunale;
- ndërtimi i besimit në mes të policisë dhe qytetarëve nëpërmjet ndërtimit të partneritetit dhe iniciativave të përbashkëta për zgjidhjen e problemeve të sigurisë në çdo bashkësi;
- përfaqësimi i pikëpamjeve dhe shqetësimeve të të gjithë qytetarëve, për çështjet e krimit dhe për çështjet tjera që lidhen me kualitetin e jetës.

Objektivat, aktivitetet dhe bartësit e tyre, rezultatet e pritura, afati kohor dhe kostoja financiare

N/R	OBJEKTIVAT	AKTIVITETET	Bartësit e aktiviteteve	Rezultatet e pritura	Afati kohor	Burimet financiare
1	-Bashkërendimi i iniciativave të përbashkëta të mekanizmave institucional për zgjidhjen e problemeve të sigurisë të çdo komuniteti	Hartimi i Planit të punës së KKS-së	Anëtarët e KKS-së	- Ndermëren iniciativave të përbashkëta për zgjidhjen e problemeve për siguri në Bashkësi	Janar, 2017	Nuk ka implikime buxhetore
2	-Senzibilizimi i qytetarëve lidhur me natyrën e krimeve, parregullsisë dhe sjelljet e dhunshme në komunitet si dhe identifikimi i brengave lidhur me sigurinë publike	-Organizimi i takimeve me qytetar në lokalitetet: Malishevë, Barije, Bellanice, Pagarushë, Carrallukë, Lumnischë, Panorc, Kijevë, Astrazup, Drenoc dhe Lladroc	Anëtarët e KKS-së	-Rritet vetëdijësimi i qytetarëve për natyrën e krimeve, -Identifikohen brengat e qytetarëve për sigurinë publike	Janar-Gusht 2017	Buxheti Komunal 1.100.00€
3	-Rritja e bashkëpunimit të mekanizmave institucional nga lëmia e sigurisë publike	-Mbajja e takimeve të rregullta ndërsituacionale dhe ndërkomunale:KKS-BVSB, -Formimi i KLSP-ve, Takime me KKS të Komunave fqinje.	Anëtarët e KKS-së, BVSB-së (KLSP)	-Shkenbim përvojash nga fusha e sigurisë së përgjithshme publike	Janar-Dhjetor 2017	Buxheti Komunal, Donacione 600.00 €

4	-Siguria në shkollat fillore dhe ato të mesme, -Siguria e nxënësve në trafik, -Vendosja e videokamerave (në ato shkolla ku mungojnë)	-Patullimi i rregulltë i Policisë, posaçërisht gjatë orarit të fillimit dhe mbarimit të orarit mësimor	Policia e Kosovës	Minimizimi i incidenteve mes nxënësve	Janar-Dhjetor 2017	Buxheti Komunal, Donacione 6.000.00 €
5	-Vendosja dhe funksionalizimi i videovezhgimit të hapësirave publike në qytetën e Malishevës	-Realizimi i projektit për vendosjen e videokamerave,	DKMSH, Policia e Kosovës, AME-MPB	-Ngjitja e Sigurisë së përgjithshme publike, -Funksionalizimi i QOE-(Qendra Operative Komunale Emergjente)	Janar-Dhjetor 2017	Buxheti Komunal, 25.000.00 €
6	-Senzibilizimi i të rinjëve për mbrojtje nga dukuritë negative që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e tyre (rreziku nga përdorimi i narkotikëve), -Informimi i nxënësve për dhënien e ndihmës së parë	-Mbajtja e ligjeratave në shkollat e Komunës së Malishevës	KKSB, DKA, DKSHMS, Kryqi i Kuq	-Ngjitja e vetëdijësimit nga rreziku i trafikimit me genie njerëzore, dhe ngjitja e bashkëpunimit ndërinstituciona në luftimin e dhe parandalimin e dhunës në familje	Janar-Dhjetor 2017	Buxheti Komunal, Donacione 300.00 €
7	-Parandalimi, mbrojtja dhe luftimi i trafikimit me genie njerëzore, -Parandalimi i dhunës në familje.	-Mbajtja e ligjeratave në shkollat e Komunës së Malishevës	KKSB, DKA, DKSHMS, Kryqi i Kuq, QPS, Policia e Kosovës, Gjakata	-Ngjitja e vetëdijësimit nga rreziku i trafikimit me genie njerëzore, dhe ngjitja e bashkëpunimit ndërinstituciona në luftimin e dhe parandalimin e dhunës në familje	Shtator-Dhjetor 2017	Buxheti Komunal, Donacione 300.00 €

8	-Organizimi dhe funksionimi i Këshillave në shkollat e komunës së Malishevës	-Fornimi i Këshillave të nxënësve në shkollë	KKSB, DKA	-Ngrihtë e pjesmarjes së të rinjëve në procesin e sigurisë publike dhe minimizimi i incidenteve mes tyre.	Janar-Dhjetor 2017	Nuk ka implikime buxhetore
9	-Siguria e të rinjëve në lokalet e nates, lojra të fatit etj.	-kontrollimi dhe përkrahimi i lokaliteteve të natës, lojra të fatit dhe monitorimi i zbatimit të orarit të punës së bizneseve	KKSB, Drejtoria Komunalet e Inspektionit, Policia e Kosoves	-Zbatimi i Rregullores Komunalet për orin e punës së bizneseve etj.	Janar-Dhjetor 2017	Nuk ka implikime buxhetore
10	-Përdorimi dhe mbajtja ilegale e armëve dhe mjeteve piroteknike gjatë ahengjeve	-Mbajtja e ligjeratave, përgaditja edhe shpërndarja e broshurave, posterëve etj.	KKSB - Policia e Kosoves	Ngrihtë e sigurisë së përgjithëshme publike, Zvogëlimi i rasteve të incidenteve gjatë festave dhe ahengjeve familjare	Janar-Dhjetor 2017	Buxheti Lokal dhe Qendror 500.00 €
11	-Siguria në Komunikacion (Patullimi i PK, shenjëzimi dhe vendosja e treguesëve të komunikacionit), Rregullimi i trotuarëve nëpër vendbanime	-Vendosja e shenjave horizontale dhe vertikale në komunikacion	KKSB, EVSB, Inspektoriat	Ngrihtë e sigurisë së përgjithëshme publike, Zvogëlimi i rasteve të incidenteve në komunikacion	Janar-Qershor 2017	Buxheti lokal, Donac. 2.000.00 €
12	-Parandalimi i prerjes së pakontrolluar të pyjeve, -Parandalimi i eksploatimit të rërës dhe zhavorit.	-Mbajtja e takimeve me qytetar për rëndësinë dhe mbrojtjen e pyjeve, -Përgaditja dhe shpërndarja e fletëpalosjeve	KKSB, DKBPZHR, Drejtoria e Inspektoriatit	-Ngrihtë e vetëdijësisë të qytetarëve për kujdesin dhe mbrojtjen e pyjeve (natyrës).	Qershor-Dhjetor 2017	Buxheti Lokal dhe Qendror 300.00 €

13	-Rreziqet nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera dhe Ambijenti	-Projektet për reagim ndaj ETHKK(Rrepelimi i Kafshëve, Spërkaftja e zonave endemike nga toka dhe ajri), -Zgjidhja e problemit të kafgshëve të braktisura (gent endacak dhe mace), -Fushata senzibilizuese nga lëmia e shendetit publik, mbrojtjes nga zjarri. -Menaxhimi i mbeturinave(eliminimi i deponieve joformale). Realizimi i Planeve për reagim ndaj ETHKK(Rrepelimi i Kafshëve, Spërkaftja e zonave endemike nga toka dhe ajri), -Mbajtja e ligjeratave në shkolla mbi rëndësin e marrjes së masave preventive -Pastrimi i deponive joformale të hujdës së mbeturinave. -Hartimi i Rregullores për zgjidhjen e problemit të Kafshëve të braktisura	DKMSH, DKBPZHR, Drejtoria e Inspektoriatit, DKSHMS, IKSHIP, MBZHR Policia e Kosoves dhe FSK-ja	-Ngritja e sigurisë së shendetit të qytetarëve- minimizimi i rasteve të pickimit dhe viktimave. -Ngritja e nivelit të vetëdijës së qytetarëve mbi rëndësin e shendetit dhe mbrojtjes nga zjarri dhe reziqe të tjera.	Mars - Gusht 2017	Buxheti Lokal dhe Qendror 120.000.00 €
----	---	--	---	---	--------------------------	---

		-Mbajtja e ligjeratave në shkollat e filloresh dhe të mesme, përgaditja edhe shpërndarja e broshurave, posterëve etj.				
		- Rrespektimi mbi të drejtat e pakicave dhe PAK,	-Zyra Komunalet për Komunitete, Zyra Komunalet për Barazi Gjimore, QPS.	Verëditësimi i pakicave dhe PAK mbi të drejtat e tyre.	Janar - Dhjetor 2017	Nuk ka implikime buxhetore
14	-Rrespektimi i të drejtave të njeriut	- Bashkëpunimi me QPS, OQ dhe OJQ për përmirësimin e kushteve socio-ekonomike(njoftimi mbi të drejtat për asistencë sociale, pension invalidor etj.				
15	-Kompenzimi	Pagesa për anëtarët e KKS-së, konform Nenet 18 të UA nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL	Drejtoria Komunalet për Buxhet dhe Financa		Janar - Dhjetor 2017	5.100.00 €
GJITHSEJ:						161.400.00 €